



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 84

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 8 qershor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 6.6.2018	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Kfw, Frankfurt am Main (KfW), për financimin e projektit “Fondi për arsimin e formimin profesional (AFP) dhe punësimin, Qendra Shumëfunktionale në Kamzë” 5201
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 6.6.2018	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtimin e një fabrike të prodhimit të paneleve sanduiçe (kapanon 1 kat dhe zyra 2 kate), strukturë me funksion prodhues, industrial, përfshirë edhe ato me material porositësi nga shoqëria “Emante” sh.p.k..... 5205
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 6.6.2018	Për disa shtesa në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të ndryshuar..... 5205
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 6.6.2018	Për shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimi” të “Bazës së tubove”, Zhupan, Fier, me sipërfaqe 49 347 m ² , në pronësi të shoqërisë “Albpetrol” sh.a..... 5206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 6.6.2018	Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve..... 5209
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 6.6.2018	Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin, kalimin, rregullat përjashtuese të prodhimit dhe kontrollin e prodhimit biologjik bimor dhe të algave të detit..... 5217

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 6.6.2018	Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për sezonin e verës 2018, në agjencinë kombëtare të zonave të mbrojtura, pranë ministrisë së turizmit dhe mjedisit.....	5223
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 6.6.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të ndryshuar.....	5225
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 6.6.2018	Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit “Ambasador i Kombit”.....	5226
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 6.6.2018	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës.....	5231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 7.6.2018	Për lirim nga detyra.....	5232
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 43, datë 5.2.2018	Për detyrimin e tregtimit dhe regjistrimit të të gjitha prodhimeve të peshkimit në qendrat e grumbullimit dhe ankandit të prodhimeve peshkore në Shirokë dhe Zogaj në liqenin e Shkodrës.....	5232
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 6, datë 30.5.2018	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara “Sekret shtetëror”.....	5232
Rregullore e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 5.6.2018	Për peshkimin e molusqeve bivalvore.....	5238
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 8704, datë 28.5.2018	Për publikimin e datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes.....	5243
	Ndreqje gabimi në vendimin nr. 316, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 82, viti 2018.....	5243
	Kërkesë për konfirmimin e vdekjes së shtetases Aishe Kovaçi.....	5244

**VENDIM**

Nr. 330, datë 6.6.2018

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN (KfW), PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “FONDI PËR ARSIMIN E
FORMIMIN PROFESIONAL (AFP) DHE
PUNËSIMIN, QENDRA
SHUMËFUNKSIONALE NË KAMZË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 22, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e projektit “Fondi për arsimin e formimin profesional (AFP) dhe punësimin, Qendra Shumëfunksionale në Kamzë”, me një grant në shumën prej 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) eurosh, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi**

**MARRËVESHJE FINANCIMI
E DATËS 28.3.2018**

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(MARRËSI) PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË DHE KfW, FRANKFURT AM
MAIN (KfW) PËR 4,500,000.00 EURO

- Fondi për Arsimin dhe Formimin
Profesional (AFP) dhe Punësimin:
Qendra Shumëfunksionale në Kamzë -
BMZ-nr. 2016 67 500

Në bazë të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar 2016, për projektin “Fondi për Arsimin dhe Formimin Profesional dhe për Punësimin” (Marrëveshja Qeveritare), Marrësi dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen Financiare si më poshtë:

Neni 1**Shuma dhe Qëllimi i Kontributit Financiar**

1.1 KfW-ja do t'i japë Marrësit një kontribut financiar deri në shumën: 4,500,000.00 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Agjencia e Zbatimit të Projektit ose AZP-ja) do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për rikonstrukcionin e infrastrukturës së repartit/*workshop*-it, si dhe për prokurimin dhe sigurimin e pajisjeve teknike dhe materialeve të mësimdhënies/didaktike në QSHF Kamzë, si dhe shërbimet përkatëse të konsulencës (Projekti), dhe kryesisht për të financuar kostot e këmbimit valutor. Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Projektit dhe të mallrave e të shërbimeve që do të financohen nga kontributi financiar me anë të një marrëveshjeje të veçantë.

1.3 Taksat dhe tarifat e tjera publike që do të mbulohen nga Marrësi, si dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga kontributi financiar.



Neni 2 Disbursimi

2.1 KfW-ja do të disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Marrësit, të përfaqësuar nga AZP-ja. Me anë të një marrëveshjeje të veçantë, Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti, të dhënat që provojnë se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

2.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disburseime pas datës 30.6.2021 apo në ndonjë datë tjetër që mund të bihet dakord ndërmjet të dyja palëve.

Neni 3 Pezullimi i disburseimeve dhe shlyerja

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disburseimet, përveç rasteve kur:

a) Marrësi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur ato bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje apo sipas marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) Marrësi nuk mund të provojë se të gjitha shumatat e disburzuara janë përdorur për qëllimin e caktuar;

d) Përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm; ose

e) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

3.2 Nëse ndonjë nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1 (b), (c) ose (d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) Në rastin e nenit 3.1 (b) ose (d), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disburzuara;

b) Në rastin e nenit 3.1 (c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave për të cilat Marrësi nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 4 Kostot dhe tarifat publike

Marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe tarifat e tjera publike që akumulohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si edhe koston e transfertave dhe koston e konvertimit/këmbimit valutor të kryera në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 5 Deklarimet kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe në zbatimin e Projektit. Kompetencat e përfaqësimit nuk skadojnë derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Marrësit të autorizuar për atë kohë.

5.2 Çdo ndryshim ose shtesë dhe çdo njoftim ose deklaratë nga palët kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e vlefshmërisë (neni 2.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë do të konsiderohet e marrë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese apo në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese sipas njoftimit të bërë palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany

(Republika Federale e Gjermanisë)

Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin:

Republika e Shqipërisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë

Faks: +355 42 228494



Neni 6 Projekti

6.1 Marrësi, i përfaqësuar nga AZP-ja

a) Përgatit, zbaton, operon dhe mirëmban Projektin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje e konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Marrësit dhe KfW-së;

b) U cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve të pavarur konsulentë të kualifikuar, si dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) Cakton kontrata për mallra dhe shërbime që të financohen nga kontributi financiar me ofertim/tenderim paraprak ndërkombëtar;

d) Siguron financim të plotë të Projektit dhe i jep KfW-së me kërkesën e saj, të dhëna që provojnë se kostot e papaguara nga ky kontribut financiar janë mbuluar;

e) Mban apo merr masa për të mbajtur libra dhe regjistra që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

f) U mundëson përfaqësuesve të KfW-së që në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe funksionimin e Projektit, si edhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

g) I paraqet KfW-së çdo lloj informacioni dhe raporti për Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së dhe

h) Me miratimin e tij, informon menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që pengon apo rrezikon seriozisht zbatimin, operimin apo qëllimin e Projektit.

6.2 Marrësi dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë përkatëse në lidhje me nenin 6.1, me anë të një marrëveshjeje të veçantë.

6.3 Për transportin e mallrave që do të financohen nga kontributi financiar, do të zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Marrësin.

Neni 7 Publikimi dhe transferimi i informacionit që ka lidhje me projektin

7.1 Në përputhje me parimet e pranura ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Projektin dhe mënyrën se si financohet gjatë negociimeve para-kontraktuale, ndërsa marrëveshja/et e lidhura me Projektin është/janë duke u zbatuar dhe në fazën pas kontraktimit (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (KfW Development Bank) (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 7.3 më poshtë) për Projektin dhe mënyrën se si financohet nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Projekt ose në financimin e tij, të tilla si:

a) Informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) Strategji biznesi;

c) Udhëzime dhe raporte të brendshme;

d) Të dhëna personale të personave fizikë;

e) Vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

7.2 KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën se si financohet gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të garantuar transparencën dhe efikasitetin:

a) Degët e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj;

c) Organizata të tjera zbatuese që përfshihen në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) Organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.



7.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacion të përzgjedhur në lidhje me Projektin dhe për mënyrën se si ai financohet gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/weg/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllime të vlerësimit të bashkëpunimit të zhvillimit të përgjithshëm gjerman për të garantuar transparencë dhe eficiencë (<http://www.deval.org/de/>).

7.4 Gjithashtu, KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Projektin dhe për mënyrën se si financohet gjatë Periudhës së Plotë për palët e treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 7.1, i cili është përjashtuar nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi do të sigurojë se personat që janë ngarkuar prej tij për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, dhënien e ndonjë kontrate për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe kërkimin e

disbursimeve të shumave të kontributit financiar, nuk do të kërkojnë, do të japin, do të premtojnë apo do të marrin një premtim për pagesa të paligjshme apo avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.3 Marrësi nuk do të lidhë asnjë transaksion apo nuk do të përfshihet në ndonjë veprimtari tjetër në lidhje me Projektin që përbëjnë shkelje të embargove që rregullojnë tregtinë e huaj apo të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo Republikës Federale të Gjermanisë.

8.4 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rezultojë prej kësaj do të plotësohet me një dispozitë, në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.5 Marrësi nuk mund të kalojë ose të transferojë, të rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

8.6 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

8.7 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes së Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.8 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi sapo Marrësi të informojë KfW-në me shkrim se janë realizuar procedurat ligjore të brendshme për t'u përmbushur nga Marrësi, por jo përpara se Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën është bazuar, të ketë hyrë në fuqi.

Bërë në dy dokumente origjinale në gjuhën angleze.

Tiranë,
në datën 23.3.2018

Frankfurt am Main,
në datën 23.3.2018

Republika e Shqipërisë,
përfaqësuar nga
Ministria e Financave
dhe Ekonomisë

KfW

**VENDIM**

Nr. 331, datë 6.6.2018

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË
TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E NJË
FABRIKE TË PRODHIMIT TË
PANELEVE SANDUIÇE (KAPANON 1
KAT DHE ZYRA 2 KATE), STRUKTURË
ME FUNKSION PRODHUES,
INDUSTRIAL, PËRFSHIRË EDHE ATO
ME MATERIAL POROSITËSI NGA
SHOQËRIA “EMANTE” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 19 889 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e

nëntë) m², sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një fabrike të prodhimit të paneleve sanduiçe (kapanon 1 kat dhe zyra 2 kate), strukturë me funksion prodhues, industrial, përfshirë edhe ato me material porositi nga shoqëria “Emante” sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për sipërfaqen prej 19 889 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) m², sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

Lidhja 1

TOKË ARË (KATEGORIA V)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Durrës	Katund i Ri	Bisht-Kamzë	1198	64/16	Shoqëria “Emante” sh.p.k.	Arë	V	19889
TOTALI								19889

VENDIM

Nr. 332, datë 6.6.2018

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E
AGJENCISË KOMBËTARE TË
BURIMEVE NATYRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në fund të paragrafit “- Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penaliteti, vlerësimi do t’i referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit.”

b) Në fund të pikës shtohet paragrafi si më poshtë vijon:



“ - Ndjek procesin e vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për sektorin e energjisë. Autoriteti kontraktues miraton raportin përfundimtar të vlerësimit. Shpenzimet për pagesën e ekspertëve vlerësues për llogaritjen e investimeve do të mbulohen nga subjekti që realizon projektin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.”.

2. Procedurat e hollësishme për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, miratohen me udhëzim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM

Nr. 333, datë 6.6.2018

**PËR SHPALLJEN “ZONË ME
PËRPARËSI ZHVILLIMI” TË “BAZËS SË
TUBOVE”, ZHUPAN, FIER, ME
SIPËRFAQE 49 347 m², NË PRONËSI TË
SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 19, dhe 8, pika 3, shkronja “dh”, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vijim të pikave 4 e 5, të kreut II, të vendimit nr. 1023, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimi” të territorit të “Bazës së tubove”, me sipërfaqe 49 347 (dyzet e nëntë mijë e treqind e dyzet e shtatë) m², pjesë e zonës kadastrale nr. 3934, në Zhupan, Fier, në përbërje të së cilës janë parcelat me

numra pasurie sipas listës në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtirja dhe kufijtë e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a., të ndjekë procedurat ligjore për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë dhe të bëjë zhvendosjen e pasurive të luajtshme, që ndodhen në këtë zonë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi




SHTOJCA NR. 1

LISTA E PASURIVE PJESË PËRBËRËSE TË “BAZËS SË TUBOVE”, ZHUPAN, FIER

Nr.	Zona kadastrale	Vendndodhja	Nr. i pronës	Sipërfaqe trualli (m ²)	Sipërfaqe objekti (m ²)
1	3934	Zhupan, Fier	115/84	12,000	43
2	3934	Zhupan, Fier	115/29	230	230
3	3934	Zhupan, Fier	115/13	96	96
4	3934	Zhupan, Fier	115/30	264	264
5	3934	Zhupan, Fier	115/14	611	611
6	3934	Zhupan, Fier	115/15	147	147
7	3934	Zhupan, Fier	115/16	1,153	1,153
8	3934	Zhupan, Fier	115/31	208	208
9	3934	Zhupan, Fier	115/32	191	191
10	3934	Zhupan, Fier	115/117	21,441	1,842
11	3934	Zhupan, Fier	115/33	383	383
12	3934	Zhupan, Fier	115/56	109	109
13	3934	Zhupan, Fier	115/82	12,514	1,140
			TOTAL	49,347	6,417



**PLAN VENDOSJE E "BAZES SE TUBOVE" NE ZK 3934 ZHUPAN
NE PRONESI TE SHOQERISE "ALBPETROL Sha " Shk.1:1000
SIPERFAQJA E TRUALLIT 49347 M2
SIPERFAQJA E OBJEKTEVE 6417 M2**





VENDIM
Nr. 335, datë 6.6.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR REGJISTRIMIN, TË PROCEDURËS
DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT
TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN
E BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), që do të importohen, do të vendosen në treg dhe do të përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. PMB-të vendosen në treg dhe përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm në rastet kur janë të regjistruara në përputhje me këtë vendim.

3. Përkufizimet e përdorura në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa përkufizimet shtesë, në kuptimin e këtij vendimi, janë:

3.1 “Lëndë vepruese”, lënda ose mikroorganizmi, përfshirë viruset, që ka një veprim, specifik ose të përgjithshëm te bimët, produktet e tyre dhe organizmat dëmtues;

3.2 “Lëndë vepruese teknike”, lënda e përdorur në prodhimin e PMB-së dhe që përmban lëndën vepruese të pastër, së bashku me papastërtitë, brenda kufijve të lejuar;

3.3 “Lëndë vepruese e re”, lënda vepruese e prodhuar dhe e patentuar nga një prodhues i caktuar, sipas rregullave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtën e autorësisë për shpikje, e cila është e miratuar me urdhër të ministrit;

3.4 “Lëndë vepruese e vjetër”, lënda vepruese, prodhimi i së cilës, mbështetur në rregullat ndërkombëtare, është i lirë dhe i miratuar me urdhër të ministrit;

3.5 “Emër tregtar i PMB-së”, emri që i jepet një PMB-je, i cili mund të jetë një emër i krijuar, shkencor apo shkencor i shoqëruar nga një markë tregtare ose emri i mbajtësit të autorizimit të tregtimit, me të cilin PMB-ja është e propozuar nga aplikanti i saj dhe me të cilin ajo regjistrohet, etiketohet dhe ambalazhohet;

3.6 “Formulim”, një përzierje e lëndës/ve vepruese me shtues të caktuar (ngjitës, lagës, emulsionues, pezullues, tretës etj.). Në bazë të këtyre shtuesve përcaktohen edhe llojet (kodet) e formulimeve të PMB-ve;

3.7 “Pajtueshmëri e PMB-së”, mundësia e bashkimit të dy ose më shumë PMB-ve gjatë trajtimit, por pa shkaktuar fitotoksicitet te bimët që trajtohen. Zakonisht, kjo pasqyrohet në dokumentacionin e PMB-së që regjistrohet;

3.8 “Vrasës me tërheqje”, një kurth i përbërë nga një feromon dhe një insekticid kontakti, në sasi të vogël, që përdoret, kryesisht, në programet e integruara të kontrollit të dëmtuesve;

3.9 “Periudhë e sigurisë”, intervali kohor, i shprehur në ditë, ndërmjet trajtimit të fundit dhe vjeljes, ndërsa, për produktet e magazinuara, ndërmjet trajtimit të fundit dhe të vendosjes në treg;

3.10 “Periudhë e rihyrjes”, intervali kohor, i shprehur në ditë, nga çasti i kryerjes së trajtimit deri kur punëtori mund të hyjë në mjedisin ose zonën e trajtuar pa përdorur mjete mbrojtëse individuale;

3.11 “PMB me natyrë inorganike”, PMB-ja që ka në përmbajtje vetëm lëndë vepruese inorganike;

3.12 “Largues (Repellent)”, lënda vepruese që, për karakteristikat specifike të erës (aromës), ngjyrës, efektit mekanik etj. është e aftë të largojë fitoparazitë të caktuar;

3.13 “Aplikant ose mbajtës i dokumentit të regjistrimit”, personi apo subjekti që prodhon një PMB, i cili ia beson prodhimin e saj një të treti ose një personi të emëruar nga prodhuesi, si përfaqësues i tij ekskluziv, për regjistrimin e PMB-së;

3.14 “Efekt i padëshiruar”, përgjigjja e padëshiruar ose e dëmshme e bimës gjatë administrimit të një PMB-je në kushte normale përdorimi;

3.15 “Efekt i padëshiruar, serioz”, çdo efekt i padëshiruar, që rezulton në tharje të bimës;



3.16 “Efekt i padëshiruar, i papritur”, çdo efekt i padëshiruar, natyra, rëndësia ose rezultati i të cilit nuk është në përputhje me përmbledhjen e karakteristikave të PMB-së;

3.17 “Seri”, një sasi e caktuar e lëndës së parë, e materialit ambalazhues ose e produktit përfundimtar, e prodhuar gjatë një procesi të vetëm ose disa proceseve në seri, e cila siguron homogjenitetin e gjithë sasisë;

3.18 “Fletudhëzues”, fletëpalosja që përmban informacion për përdoruesin dhe që shoqëron PMB-në e gatshme për përdorim;

3.19 “Reklamim për PMB-në”, çdo formë informimi, veprimtari mbështetëse ose nxitëse e destinuar për të rritur informimin për përdorimin e PMB-së;

3.20 “Doza e përdorimit”, sasia e lëndës vepruese ose e PMB-së për njësinë e sipërfaqes, duke përcaktuar dhe sasinë e tretësirës spërkatëse që duhet të përdoret. Mund të shprehet edhe në përqindje;

3.21 “PMB me prejardhje bimore”, PMB-së, lënda vepruese e së cilës përmban një ose më shumë lëndë me prejardhje bimore, të kombinuara me një a më shumë përgatesa me prejardhje bimore;

3.22 “Farmakovigjilencë”, shkenca dhe veprimtaria që merret me zbulimin, evidentimin dhe vlerësimin e efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të PMB-ve, për parandalimin e mundshëm të tyre, si dhe me çdo problem që lidhet me sigurinë dhe efektshmërinë e PMB-ve;

3.23 “Tërheqës (Feromon)”, substanca e sekretuar jashtë organizmit, shumë avulluese dhe që metabolizohet menjëherë, sapo kërkohet transmetimi i mesazhit, ndërmjet insekteve të së njëjtës specie. Është lëndë me erë karakteristike të femrave të dëmtuesit që do të kontrollohet, e cila përdoret për tërheqjen e meshkujve në “kurthe seksuale”. Përdoret, kryesisht, në programet e integruara të kontrollit të dëmtuesve, si dhe në monitorimin e tyre.

II. REGJISTRIMI I PMB-ve

1. Të gjitha PMB-të, që vendosen në treg dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë vetëm të regjistruara.

2. Në Republikën së Shqipërisë pranohen për regjistrim vetëm PMB-të që janë të regjistruara në një nga vendet e Bashkimit Evropian.

3. Regjistrimi i PMB-ve kryhet nga Komisioni i

Regjistrimit të PMB-ve (KRPMB), i ngritur në ministri. Komisioni është organ kolegjal teknik, i përhershëm, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të PMB-ve. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;

b) Dy përfaqësues nga ministria;

c) Një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

ç) Një përfaqësues nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).

Sekretar i komisionit të regjistrimit të PMB-ve është specialisti që mbulon PMB-të pranë strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB).

4. Emrat e anëtarëve të komisionit, sipas shkronjave “c” e “ç”, të pikës 3 të këtij kreu, propozohen nga institucionet përkatëse. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e PMB-ve. Ata, paraprakisht, duhet të deklarojnë marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet e tregtimit të PMB-ve.

5. Komisioni është organ vendimmarrës dhe funksionon, si më poshtë vijon:

5.1 Komisioni mbledhet kur e kërkon kryetari ose 2/3 e anëtarëve të tij;

5.2 Radha e shqyrtimit të dokumentacionit për regjistrim të PMB-ve bëhet sipas datës së pranimit të tyre;

5.3 Komisioni i zhvillon mbledhjet me pjesëmarrjen e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij dhe, pasi shqyrton mendimet e ISUV-it, merr vendim me 2/3 e anëtarëve të pranishëm;

5.4 Komisioni, në mbledhjet e tij, shqyrton:

a) Etiketën përfundimtare të çdo PMB-je, bazuar në p/etiketën e paraqitur nga aplikanti;

b) Regjistrimin e PMB-ve në procedurë regjistrimi;

c) Riregjistrimin e PMB-ve që kanë përfunduar afatet dhe që janë në procedurë riregjistrimi;

ç) Modifikimin e etiketës së PMB-së, për sa u përket:

i) zgjerimit të fushës së përdorimit;

ii) dozave të përdorimit;

iii) parazitëve që kontrollojnë;

iv) mënyrave të përdorimit;

v) ambalazhit bazë (forma, madhësia, lloji, treguesit cilësorë teknikë të tij);



vi) periudhës dhe kushteve të ruajtjes;

vii) kushteve të përdorimit për PMB-të që mund përbëjnë rrezik për shëndetin e përdoruesve, të bimëve ku përdoren, konsumatorëve, ndikimit në mjedis;

d) Ndryshimin e formulimit dhe/ose të përmbajtjes në sasi ose përqindje të lëndës/ve vepruese të një PMB-je të regjistruar më parë.

5.5 Në përfundim të mbledhjes hartohet një procesverbal përmbledhës për vendimet e marra. Procesverbali mbahet në tri kopje, nga të cilat, dy kopje mbahen nga SPMB-ja dhe kopja e tretë depozitohet në arkivin e ministrisë, bashkë me një kopje të dokumenteve të regjistrimit (certifikatë dhe etiketë). Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje;

5.6 Dokumentet e regjistrimit (certifikata dhe etiketa) të PMB-ve të miratuara përgatiten nga sekretari dhe firmosen nga kryetari i komisionit brenda 10 ditëve, nga data e mbledhjes së komisionit;

5.7 Dokumentet e regjistrimit të PMB-ve të miratuara u jepen aplikantëve nëpërmjet zyrës së protokollit të ministrisë, pas kryerjes së pagesës, duke shënuar numrin dhe datën e protokollit në ditën e marrjes së tyre.

6. Vendimi për refuzimin e regjistrimit mund të ankimohet pranë ministrit.

7. SPMB-ja përgatit listën e PMB-ve të regjistruara sa herë që pëson ndryshime dhe e publikon në faqen zyrtare të ministrisë.

8. Lista përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emrin tregtar të PMB-së;

b) Emrin e lëndës/ve vepruese të saj;

c) Aplikantin e PMB-së;

ç) Prodhuesin e PMB-së;

d) Klasifikimin e PMB-së sipas parazitëve që kontrollon (insekticid, herbicid, fungicid etj.);

dh) Datën dhe numrin e regjistrimit të PMB-së.

9. Tarifat administrative për regjistrimin e PMB-ve përballohen nga aplikantët dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

10. Tarifat administrative përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

III. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIM

1. Një PMB regjistrohet nëse përmbush këto kërkesa:

a) Lënda/ët vepruese në përmbajtje të saj të jenë të miratuara me urdhër të ministrit;

b) Të jetë mjaftueshmërisht efektive për kontrollin e organizmave të dëmshëm, të përcaktuar në dosjen e PMB-së;

c) Të mos ketë efekte të papranueshme (të dëmshme) në bimët apo produktet bimore ku përdoret;

ç) Të mos shkaktojë vuajtje dhe dhimbje të papranueshme të vertebrorët që i kontrollojnë;

d) Të mos ketë efekt të dëmshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi shëndetin e njerëzve apo të kafshëve, që e marrin atë nëpërmjet ujit të pijshëm a ushqimit ose tek ujërat nëntokësore;

dh) Të mos ketë ndikim të papranueshëm në mjedis, veçanërisht, për sa u përket:

i) shpërndarjes në mjedis, me referim të veçantë në ndotjen e ujërave, përfshirë ujin e pijshëm dhe ujërat freatike;

ii) ndikimit të speciet e bimëve e të kafshëve, që nuk janë objekt trajtimi;

iii) përcaktimit të distancave të largësisë që duhen respektuar në momentin e përdorimit të PMB-ve, për mbrojtjen e burimeve ujore, bimëve dhe kafshëve.

e) Të plotësojë kërkesat për paketimin dhe etiketimin e saj sipas legjislacionit në fuqi;

ë) Vetitë fiziko-kimike të PMB-së të jenë të pranueshme për qëllimin e përdorimit dhe të magazinimit;

f) Metodën e përcaktimit të lëndëve vepruese, të papastërtive, të mbetjeve toksike ose ekologjikisht të dëmshme, mbetjeve në tokë, ujë, ajër, bimë ose produkt bimor, të jenë pjesë e dosjes së regjistrimit;

g) Mbetjet e bimëve apo të produkteve bimore, që përdoren si ushqim për kafshët ose për njerëzit, të mos tejkalojnë kufijtë e lejuar;

gj) Të plotësojë standardet sipas specifikimeve të Organizatës për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) për produktet e mbrojtjes së bimëve;

h) Të mos emërtohet me një emër tregtar, i cili:



i) i korrespondon emrit tregtar të një PMB-je të regjistruar më parë;

ii) mund të çojë në konfuzion ose mashtrim lidhur me efektin dhe vetitë e një PMB-je.

2. Regjistrimi duhet të saktësojë kërkesat e tregutit e të përdorimit të PMB-së dhe, të paktën, ato të nevojshmet, për të qenë në rregull me kërkesat e shkronjave “b” deri në “e”, të pikës 1, të këtij kreu.

IV. PËRMBAJTJA E DOSJES SË PMB-SË. APLIKIMI PËR REGJISTRIM

1. Aplikimi për regjistrimin e PMB-së përmban:

a) Kërkesën e aplikantit për regjistrimin e PMB-së, në gjuhën shqipe;

b) Të dhënat teknike të dosjes së regjistrimit të PMB-së, në gjuhën shqipe ose angleze, në dosje dhe në formë elektronike (CD), të miratuara me urdhër të ministrit;

c) Të dhënat që provojnë se PMB-ja është e regjistruar nga aplikanti në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të regjistrimit nga subjekti që e ka regjistruar në një nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilat janë: certifikata e regjistrimit ose vërtetimi i lëshuar nga institucionet zyrtare kompetente, numri i regjistrimit, sipas adresës elektronike të shtetit që e ka regjistruar PMB-në dhe etiketa përkatëse. Etiketa të jetë e përkthyer dhe në gjuhën shqipe;

ç) Dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”. MSDS-ja të jetë e përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

2. Për PMB-të, të cilat në përmbajtje të tyre kanë lëndë vepruese të vjetra, të miratuara me urdhër të ministrit, kërkesat sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, plotësohen në mënyrë të përmbledhur.

Në rastet kur aplikanti ka mbrojtur në institucionin përgjegjës në BE lëndën/ët vepruese në përmbajtje të PMB-së, në kërkesat e shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, nuk kërkohen të dhënat për lëndën vepruese, por vetëm dokumenti që provon se ajo është mbrojtur në BE nga aplikanti.

3. Për PMB-të, të cilat në përmbajtje të tyre kanë lëndë vepruese me prejardhje bimore, acidesh yndyrore etj., dhe që përdoren si tërheqëse, vrasëse me tërheqje, larguese

(repelentë) etj. të miratuara me urdhër të ministrit, kërkesat sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, plotësohen në mënyrë të përmbledhur vetëm për PMB-në. Regjistrimi bëhet me miratim nga Komisioni i Regjistrimit të PMB-ve, pa kaluar dokumentacioni në ISUV.

4. Për PMB-të, të cilat në përmbajtje të tyre kanë lëndë vepruese të reja, të miratuara me urdhër të ministrit, aplikimi kryhet vetëm nga patentuesit e tyre ose aplikantët e autorizuar prej tyre dhe kërkesat, sipas shkronjës “b”, të pikës 1 të këtij kreu, plotësohen në mënyrë të përmbledhur, vetëm për PMB-në.

5. Për PMB-të me natyrë inorganike, si dhe ato, që në përmbajtje të tyre kanë vajra minerale, dokumentacioni teknik, sipas kërkesave të shkronjës “b” të pikës 1, të këtij kreu, përfshin, në mënyrë të përmbledhur, vetëm të dhënat për PMB-në.

6. Për PMB-të, të cilat në përmbajtje të tyre kanë lëndë vepruese që nuk janë me status të përcaktuar, të miratuara me urdhër të ministrit, kërkesat sipas shkronjës “b”, të pikës 1 të këtij kreu, plotësohen në mënyrë të përmbledhur. Nëse lënda vepruese në përmbajtje të PMB-së është e re, aplikimi kryhet sipas kërkesave të pikës 4 të këtij kreu.

7. Të dhënat sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij kreu, mbahen në arkivin e SPMB-së.

V. PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PMB-VE

1. Sekretari merr në dorëzim dosjen e regjistrimit dhe e fut në procedurë regjistrimi kur ajo përmbush kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në këtë vendim, verifikimi i të cilave bëhet brenda 20 ditëve, nga dita e marrjes në dorëzim të dosjes. Nëse dosja nuk është e plotë ose nuk përmbush kërkesat e përgjithshme, sipas dispozitave të këtij vendimi, brenda 20 ditëve, nga dita e marrjes në dorëzim të dosjes, aplikanti vihet në dijeni, ku i paraqiten edhe arsyet e mospranimit ose kërkesat për të dhëna shtesë.

2. Në rastet e përmbushjes së kërkesave të përgjithshme, të përcaktuara në këtë vendim, dokumentacioni teknik i PMB-së, në dosje dhe në formë elektronike (CD), dërgohet në ISUV menjëherë pas përfundimit të verifikimit të kryer nga sekretari, por jo më shumë se 25 ditë, nga data e marrjes në dorëzim të dosjes.



3. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) bën vlerësimin e dokumentacionit teknik të PMB-ve në procesin e regjistrimit të tyre.

Vlerësimi bëhet në bazë të njohurive bashkëkohore tekniko-shkencore dhe në bazë të përmbajtjes e të vlerësimit të dokumentacionit teknik, si dhe duke pasur parasysh të gjitha kushtet normale të përdorimit dhe pasojat nga përdorimi.

ISUV-i bën këtë vlerësim brenda 25 ditëve, nga data e marrjes së dokumentacionit teknik, dhe dërgon me shkrim mendimin në SPMB.

4. Sekretari përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e radhës së KRPMB-së brenda 10 ditëve, nga ardhja e mendimeve të ISUV-it.

5. Sekretari përgatit dokumentin e regjistrimit për çdo PMB të miratuar. Kryetari i komisionit njofton aplikantin për regjistrimin ose jo të PMB-së.

VI. DOKUMENTI I REGJISTRIMIT

1. Dokumenti i regjistrimit të PMB-së përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën me fletudhëzuesin. Certifikata e regjistrimit të PMB-së lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketën dhe fletudhëzuesin.

Dokumenti i regjistrimit të PMB-së mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra mbahet në arkivin e ministrisë, njëra në arkivin e SPMB-së ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.

1.1 Certifikata e regjistrimit, e cila plotësohet në gjuhën shqipe, përmban:

- a) Emrin tregtar të PMB-së;
- b) Numrin dhe datën e regjistrimit;
- c) Emrin e aplikantit dhe adresën e tij;
- ç) Emrin e prodhuesit dhe adresën e tij;
- d) Emrin/at dhe adresën/at e fabrikimit të PMB-së;
- dh) Emrin e lëndës/ve vepruese të tij;
- e) Tipin e PMB-së (p.sh., fungicid, insekticid, nematocid etj.);
- ë) Klasifikimin e PMB-së (shumë helmues, helmues etj.), duke theksuar shënimin për PMB-të me rrezikshmëri të lartë;
- f) Përmbajtjen e lëndës/ve vepruese në %, g/lit ose g/kg;
- g) Tipin e formulimit;

gj) Pamjen e jashtme të PMB-së (granula me ngjyrë ..., lëng me ngjyrë ..., pluhur me ngjyrë ... etj.);

h) Kushtëzimet, që, eventualisht, mund të shoqërojnë regjistrimin;

i) Afatin e përfundimit të regjistrimit;

j) Mënyrën e përdorimit të PMB-së (me shënimin: shih etiketën dhe fletudhëzuesin bashkëlidhur).

1.2 Etiketa e PMB-së përmban:

a) Emrin tregtar dhe përcaktimin “Produkt për mbrojtjen e bimëve”;

b) Emrin dhe adresën e mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikantit);

c) Për PMB-të e klasifikuara “PMB me rrezik të lartë”, shprehjet: “PMB me rrezik të lartë”, “Të përdoret vetëm nga përdorues profesionistë”;

ç) Emrin dhe adresën e prodhuesit të PMB-së;

d) Emrin/at e zakonshëm të lëndës/ve vepruese;

dh) Përmbajtjen e lëndës/ve vepruese të PMB-ja;

e) Numrin e serisë ose shenja të tjera identifikuese;

ë) Rreziqet e veçanta për shëndetin e njerëzve, të kafshëve e ndikimit në mjedis, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve;

f) Tipin e formulimit;

g) Tipin e PMB-së (p.sh., insekticid, herbicid etj.);

gj) Sasinë neto të PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë;

h) Llojin e ambalazhit bazë (për formulimet lëngje, COEX ose HDPE; për formulimet e ngurta, material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia);

i) Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje;

j) Rekomandimet për kushtet e ruajtjes;

k) Fjalët “Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”.

1.3 Fletudhëzuesi i PMB-së, përveç të dhënave të etiketës, sipas pikës 1.2 të këtij kreu, përmban përshkrimet për:

a) Masat për mbrojtjen e njerëzve, të kafshëve dhe mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve;



b) Shenjat e përgjithshme, në rast helmimi, udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun;

c) Përdorimin, për të cilin PMB-ja është e regjistruar;

ç) Udhëzimet për përdorimin, si dhe dozat e përdorimit, të shprehura në sistemin metrik, për kulturat dhe kushtet specifike bujqësore, agroteknike e mjedisore;

d) Kushtet specifike bujqësore, të mjedisit dhe të shëndetit të bimëve, në të cilat PMB-ja mund të përdoret ose jo;

dh) Rekomandimet lidhur me shmangien e rezistencës;

e) Periudhën e sigurisë ndërmjet kohës së përdorimit të PMB-së dhe:

i) mbjelljes së bimës, ku përdoret;

ii) mbjelljes së bimëve pasardhëse;

iii) rihyrjes së njerëzve apo kafshëve në zonën ku është përdorur PMB-ja;

iv) vjeljes së prodhimit;

v) përdorimit të bimës për shitje ose për konsum (periudha e sigurisë ose karencë);

vi) përdorimit të PMB-ve të tjera në të njëjtën zonë ose mbi të njëjtën bimë;

ë) Të dhënat për fitotoksicitetin, ndjeshmërinë e kultivarëve të ndryshëm dhe ndaj çdo efekti të padëshirueshëm serioz ose të papritur, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi produktet bimërore ose ato me origjinë bimërore, bashkërisht me intervalet e vërejtura ndërmjet aplikimit dhe mbjelljes së kulturës në fjalë ose të kulturës pasardhëse;

f) Të dhënat për pajtueshmërinë e PMB-së;

g) Instruksionet për asgjësimin e PMB-së dhe të ambalazheve;

gj) Instruksionet për përdorimin pa rrezik të PMB-së apo të ambalazhit të saj, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve.

2. Etiketa e ambalazhit të PMB-së nuk duhet të përmbajë shënime të tilla si: “jo helmues”, “i padëmshëm” ose shënime të tjera të ngjashme, apo figura të bimëve, pjesëve të bimëve, produkteve bimërore, insekteve, si dhe objekteve të tjera, të cilat tërheqin vëmendjen e njerëzve dhe, sidomos, të fëmijëve.

3. Në etiketë duhet të shënohet nëse PMB-ja mund të përdoret kur bletët ose insektet e dobishme janë në aktivitet apo kur kulturat

dhe/ose bimët e dëmshme janë në lulëzim, ose të vendosen shënime të tjera analoge, që njoftojnë për mbrojtjen e bletëve dhe të insekteve të dobishme, nëse regjistrimi parashikon qartësisht përdorimin gjatë periudhave të pranisë së bletës ose të organizmave të tjerë të specifikuar, dhe që rreziket për to janë të parëndësishme. Duhet të shënohet, gjithashtu, edhe distanca e largësisë nga burimet ujore, që duhet respektuar për mbrojtjen nga përdorimi i PMB-ve.

4. Piktogramet e rrezikut, si dhe përcaktimet për rrezikun e kujdesin vendosen sipas legjislacionit që rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e kimikateve.

5. Përmbajtja e etiketës duhet të jetë në gjuhën shqipe.

VII. AFATET, RISHIKIMI, MODIFIKIMI, PEZULLIMI, ÇREGJISTRIMI DHE RIREGJISTRIMI I PMB-ve

1. Afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të PMB-ve janë, si më poshtë vijon:

a) 1 vit më shumë se afatet e lëndës/ve vepruese në përmbajtje të tyre, të miratuara me urdhër të ministrit;

b) 3-vjeçare, deri në marrjen e statusit përfundimtar të lëndës/ve vepruese që nuk janë me status të përcaktuar, të miratuara me urdhër të ministrit;

c) Të përditësuara, sipas urdhrit të ministrit për përditësimin e lëndës/ve vepruese në përmbajtje të PMB-ve.

2. Ministri, në rastet emergjente, kur kontrolli i një paraziti gjykohet se nuk realizohet me PMB-të e regjistruara, me propozimin e SPMB-së urdhëron lejimin e përkohshëm, për një periudhë deri në 120 (njëqind e njëzet) ditë, të tregtimit ose përdorimit të një sasive të caktuar e të kontrolluar të një PMB-je të peregjistruar, e cila ka në përmbajtje të saj lëndë vepruese të miratuara me urdhër të ministrit.

3. Rishikimi i regjistrimit të një PMB-je kryhet në rastet kur:

a) Një nga kushtet ku është bazuar regjistrimi, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, është ndryshuar në mënyrë thelbësore;

b) Aplikanti e kërkon një gjë të tillë, duke paraqitur dokumentacionin shtesë për dosjen e regjistrimit;

c) Përdorimi i PMB-së mund të sjellë rreziqe për shëndetin e njerëzve, të kafshëve ose të mjedisit.



4. Modifikimi i dokumentit të regjistrimit të një PMB-je kryhet kur ka ndryshim të:

- a) Emrit tregtar të PMB-së;
- b) Mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikantit) të PMB-së;
- c) Prodhuesit të PMB-së;
- ç) Prodhimit të PMB-së (shtim, transferim në një stabiliment tjetër prodhues);
- d) Sasisë neto të PMB-së, që ndodhet në ambalazhin bazë;
- dh) Mënyrave të përdorimit dhe sasive të përdorura të PMB-së;
- e) Periudhës dhe kushteve të ruajtjes së PMB-së;
- ë) Tipit dhe materialit të ambalazhit bazë të PMB-së;
- f) Formulimit të PMB-së;
- g) Zgjerimit të fushës së përdorimit të PMB-së;
- gj) Përmbajtjes në sasi ose përqindje të lëndës/ve vepruese të PMB-së.

Në të gjitha rastet e përcaktuara në këtë pikë, aplikanti duhet të paraqesë kërkesë në gjuhën shqipe.

5. Pezullimi i regjistrimit të një PMB-je kryhet nga kryetari i komisionit, në rastet kur:

- a) PMB-ja nuk plotëson kushtet për të qenë e regjistruar, sipas kërkesave të parashtruara në këtë vendim;
- b) Vërehet se në dosjen e regjistrimit janë paraqitur të dhëna false ose të gabuara;
- c) Ka të dhëna se PMB-ja është futur në treg përpara se të ketë filluar procedura për regjistrim;
- ç) Aplikanti e kërkon vetë një gjë të tillë;
- d) Në sistemin e farmakovigjilencës;
- i) PMB-ja nuk plotëson performancat e parashikuara dhe efektet që priteshin, sipas specifikimeve të dhëna në dosjen e saj;
- ii) të dhënat e reja specifike tregojnë se tregtimi dhe përdorimi i kësaj PMB-je përbën një rrezik, që vlerësohet i papranueshëm.

5.1. Në rastet kur pezullohet regjistrimi, aplikanti njoftohet për arsyet e marrjes së këtij vendimi.

5.2. Pas pezullimit të regjistrimit, nëse PMB-ja është në treg, ajo duhet të përdoret brenda afateve të skadencës së saj.

6. Çregjistrimi i një PMB-je kryhet nga kryetari i komisionit, në rastet kur:

a) PMB-ja përmban lëndë vepruese, të cilat janë të hequra me urdhër të ministrit;

b) Aplikanti e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë;

c) Ka përfunduar afati i regjistrimit të saj dhe nuk është bërë kërkesë nga aplikanti për përditësim ose riregjistrim;

ç) Nuk plotësohen nga aplikanti kërkesat sipas pikës 5, të këtij kreu.

6.1. Aplikanti duhet të njoftohet në rastet e çregjistrimit.

6.2. Pas çregjistrimit, nëse PMB-ja është ende në treg, ajo duhet të përdoret brenda afateve të skadencës së saj.

7. Rinovimi i regjistrimit (reregjistrimi) të një PMB-je mund të kryhet kur:

a) Mbaron afati i regjistrimit të saj;

b) Kjo kërkohet nga aplikanti, para përfundimit të afatit të regjistrimit.

8. Për riregjistrim, aplikanti paraqet:

a) Dokumentacionin me të dhënat e sigurisë së PMB-së (MSDS);

b) Të dhëna të tjera lidhur me etiketën e saj, nëse ka ndryshime nga regjistrimi i mëparshëm;

c) të dhënat që provojnë se është e regjistruar nga aplikanti në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose se aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të regjistrimit nga subjekti që e ka regjistruar në një nga vendet e Bashkimit Evropian.

Rinovimi i regjistrimit kryhet direkt, me miratim nga komisioni, pa kaluar dosja në ISUV.

VIII. EFEKTET E RREZIKSHME, MBROJTJA (REZERVIMI) E TË DHËNAVE DHE KONFIDENCIALITETI

1. Aplikanti duhet të vërë në dijeni SPMB-në për PMB-në në procedurë regjistrimi ose të regjistruar për çdo informacion të ri, për mbetjet e saj ose për lëndën/t vepruese, për efektet potenciale të rrezikshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, për ujërat nëntokësore dhe për mjedisin.

2. Në regjistrimin e një PMB-je, të dhënat e dosjes së regjistrimit nuk përdoren në favor të aplikantëve të tjerë, nëse nuk është dhënë autorizimi nga prodhuesi ose mbajtësi i dokumentit të regjistrimit të PMB-së.

3. Konsiderohet konfidencial informacioni, për:

a) Metodatat e prodhimit;



b) Specifikimin e papastërtive të lëndës/ve vepruese teknike, përveç papastërtive të spikatura;

c) Rezultatet e llojeve të prodhimit të lëndës/ve vepruese, përfshirë papastërtitë;

ç) Metodot e analizave të papastërtive në lëndën/t vepruese teknike, përveç metodave të papastërtive të spikatura;

d) Lidhjet ndërmjet një prodhuesi ose importuesi dhe aplikantit ose mbajtësit të autorizimit;

dh) Të dhënat për përbërjen e plotë të produktit për mbrojtjen e bimëve;

e) Emrat dhe adresat e personave të përfshirë në testimin e kafshëve kurrizore.

Nëse aplikanti zbulon përdorimin e informacionit konfidencial, informon menjëherë drejtuesin e SPMB-së.

4. Nuk vlerësohen konfidenciale të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emri dhe përmbajtja e lëndës/ve vepruese dhe emri i PMB-së;

b) Emri i lëndëve të tjera të rrezikshme;

c) Informacioni bazë për të plotësuar kërkesat për etiketimin;

ç) Të dhënat fiziko-kimike për lëndët vepruese dhe PMB-të;

d) Metodot e përdorura për të bërë të padëmshme lëndët vepruese dhe PMB-të, përfshirë antidotet dhe mjetet për trajtimin e rasteve të helmimit në njerëz e kafshë nga këto PMB dhe lëndë vepruese;

dh) Përmbledhja e rezultateve të provave për sigurinë e lëndëve vepruese dhe të PMB-ve të njerëzit, kafshët e mjedisi, si dhe efikasiteti i tyre të bimët;

e) Metodot e rekomanduara dhe masat për të ulur rrezikun që mund të vijë nga përdorimi, ruajtja e transporti i tyre, si dhe për të shmangur rrezikun e ndezjes ose të ndonjë natyre tjetër;

ë) Metodot e analizës;

f) Metodot për largimin dhe bërjen të padëmshme të PMB-ve, lëndëve vepruese dhe/ose të ambalazhit të tyre;

g) Masat për pastrimin, në rast të rrjedhjeve aksidentale;

gj) Masat e ndihmës së shpejtë, në rast helmimi të personave;

h) Të dhënat për efikasitetin e PMB-së;

i) Të dhënat për rrezikun në mjedis.

IX. INFORMIMI DHE REKLAMIMI

1. Ministria informon në medien e shkruar ose elektronike veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i PMB-ve.

2. Reklamimi lejohet vetëm për PMB-të e regjistruara dhe në përputhje me dokumentin e regjistrimit.

3. Reklamimi në medien e shkruar ose elektronike miratohet nga drejtuesi i SPMB-së, pas kërkesës së paraqitur nga mbajtësi i dokumentit të regjistrimit.

4. Në varësi të tipit të reklamës, tekstet dhe piktogramet duhet të jenë të lexueshme e të dëgjueshme qartë, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me mbrojtjen e njerëzve, të kafshëve dhe mjedisit.

5. Reklamimi i veçantë për PMB-të që dëmtojnë ose jo bletët apo insektet e dobishme kryhet:

a) Kur ato janë në aktivitet;

b) Kur kulturat dhe/ose bimët e dëmshme janë në lulëzim;

c) Për kujdesin e mbrojtjes së insekteve pjalmuese në kultivimin e perimeve në mjedise të mbrojtura.

6. Reklamimi nuk mund të përfshijë:

a) Të dhënat konfidenciale të PMB-ve;

b) Shënime të tilla si: “jo helmues”, “i padëmshëm” ose shënime të tjera të ngjashme; figura të bimëve, pjesëve të bimëve, produkteve bimore, insekteve, si dhe objekteve të tjera, të cilat tërheqin vëmendjen e njerëzve dhe, sidomos, të fëmijëve;

c) Sponsorizimet për kongrese, konferenca shkencore, takime promovuese, që ndiqen nga profesionistët e PMB-ve, në bazë të kontratave ligjrisht të rregullta ndërmjet palëve.

7. Subjektet, që organizojnë veprimtari sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 6, të këtij kreu, janë të detyruara të raportojnë një herë në vit të SPMB-ja në lidhje me këto veprimtari.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Për shqyrtimin e aplikimeve për regjistrimin e PMB-ve të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të zbatohen dispozitat në fuqi në momentin e aplikimit.



2. Vendimi nr. 1555, datë 12.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 336, datë 6.6.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
TË HOLLËSISHME PËR PRODHIMIN,
KALIMIN, RREGULLAT
PËRJASHTUESE TË PRODHIMIT
DHE KONTROLLIN E PRODHIMIT
BIOLOGJIK BIMOR DHE TË ALGAVE
TË DETIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 3, 18, 24 e 33, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin, kalimin, rregullat përjashtuese të prodhimit dhe kontrollin e prodhimit biologjik bimor dhe të algave të detit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, trupat e kontrollit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Inspektorati Shtetëror

¹ Ky vendim është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 889/2008, datë 5.9.2008, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit 834/2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike në lidhje me prodhimin biologjik, etiketimin dhe kontrollin”, të ndryshuar. Numri CELEX: 02008R0889-20160507, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 250, datë 18.9.2008, faqe 1–17.

i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e hollësishme:

a) për prodhimin biologjik bimor dhe algat e detit;

b) për kalimin e prodhimit bimor dhe algave të detit në prodhim biologjik;

c) përjashtuese për prodhimin bimor;

ç) për kontrollin e prodhimit biologjik bimor dhe algave të detit.

2. Për prodhimin e algave të detit përcaktohen rregullat për mbledhjen dhe kultivimin e tyre. Algat e detit përfshijnë të gjitha algat shumëqelizore detare, fitoplanktonet dhe mikroalgat.

Neni 2
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Energjia nga burimet e rinovueshme”, sipas ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

2. “Fermë”, sipas ligjit nr. 9817/2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

3. “Jobiologjike”, që nuk vjen nga prodhimi i prodhuar në përputhje me ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, ose nuk ka lidhje me të.

4. “Njësi prodhimi”, të gjitha asetet që përdoren në një sektor prodhimi, të tilla si: objektet prodhuese, toka bujqësore, kullotat, sipërfaqe të hapura, objektet ku mbahen kafshët, vaska peshkimi, sistemet e kontrollit/ hermetizimit të algave të detit, objektet për magazinimin e



prodhimeve bujqësore, produkteve bimore, produkteve shtazore, produkteve të algave të detit, lëndët e para dhe çdo *input*-i tjetër që lidhen me një sektor të veçantë të prodhimit.

5. “Prodhimi hidroponik”, metoda e rritjes së bimëve me rrënjët e tyre vetëm në një tretësirë ushqyese minerale ose në një mjedis të ngurtë, si: perlitë, zhavorr ose fibër guri, të cilave u shtohet një tretësirë ushqyese.

6. “Pleh organik”, produktet e jashtëqitjes nga blegtoria apo një përzierje e produkteve të jashtëqitjes nga blegtoria, të lëngshme dhe të ngurta, si dhe në formë të përpunuar.

KREU II

RREGULLAT PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK BIMOR DHE ALGAT E DETIT DHE RREGULLAT PËRJASHTUESE

SEKSIONI I

Prodhimi bimor

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

Në prodhimin biologjik bimor, përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, zbatohen edhe kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.

Neni 4

Menaxhimi dhe plehërimi i tokës

1. Në prodhimin biologjik bimor përdoren vetëm plehurat dhe përmirësuesit e tokës të përcaktuara në listën e produkteve dhe substancave, sipas nenit 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, në masën e nevojshme. Operatorët duhet të mbajnë regjistrat për përdorimin e këtyre produkteve.

2. Vlera e përgjithshme e plehut organik të përdorur në fermë nuk duhet të kalojë sasinë prej 170 kg azot në vit/ha. Kjo sasi përdoret vetëm për përdorimin e plehut organik, të plehut të thatë të fermës, të plehut të dehidruar të shpendëve, jashtëqitjet e kafshëve të kompostuara, përfshirë plehun e shpendëve, plehun e fermës së kompostuar dhe jashtëqitjet e lëngshme të kafshëve.

3. Fermat e prodhimit biologjik mund të lidhin kontratë me fermat e tjera që zbatojnë rregullat e prodhimit biologjik, me qëllim shpërndarjen e plehut të tepërt nga prodhimi biologjik. Kufiri maksimal, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni llogaritet duke marrë parasysh sasinë e të gjitha njësive të prodhimit biologjik të përfshira në këtë kontratë.

4. Për të përmirësuar kushtet e përgjithshme të tokës ose për sigurimin e lëndëve ushqyese në tokë ose në bimët bujqësore mund të përdoren preparate të prodhuara nga mikroorganizma.

5. Për aktivizimin e kompostimit të plehrave përdoren preparate me bazë bimore ose preparate të prodhuara nga mikroorganizmat.

Neni 5

Ndalimi i prodhimit hidroponik

Në prodhimin biologjik bimor ndalohet përdorimi i metodës së prodhimit hidroponik.

Neni 6

Menaxhimi i dëmtuesve, sëmundjeve dhe bimëve të padëshirueshme

1. Në prodhimin biologjik bimor, kur është e nevojshme, përdoren vetëm pesticidet e përcaktuara në listën e produkteve dhe substancave, sipas nenit 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”. Operatorët mbajnë dokumentacionin për përdorimin e pesticideve.

2. Për pesticidet që përdoren në kurthe ose metoda çorientuese, përveç ferromoneve, kurthet dhe/ose metodat çorientuese duhet të parandalojnë çlirimin e substancave të ndaluara në mjedis dhe kontaktin e produkteve të përdorura me bimët e kultivuara. Kurthet, pas përdorimit, mbledhen dhe hidhen në vende të caktuara të riciklimit, për të shmangur mundësinë e përhapjes së tyre.

Neni 7

Rregulla të veçanta për prodhimin e kërpuhave

Për prodhimin e kërpuhave, substraktet përdoren vetëm nëse përmbajnë përbërës të mëposhtëm:



a) Plehun e fermës dhe jashtëqitjet e kafshëve nga:

i) fermat që prodhojnë sipas metodës së prodhimit biologjik;

ii) kur produkti i përcaktuar në nënndarjen “i” nuk gjendet, përdoren substancat e përcaktuara në listën e produkteve dhe substancave, sipas nenit 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, dhe kur nuk kalojnë 25% të peshës totale të përbërësve të substraktit, me përjashtim të materialit mbulues e të ujit të shtuar para kompostimit të plehrave;

b) Produktet me prejardhje bujqësore, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni;

c) Torfë që nuk është trajtuar kimikisht;

ç) Dru që nuk trajtohet me produkte kimike pas prerjes;

d) Ujin, tokën dhe produktet minerale të përcaktuara në listën e produkteve dhe substancave, sipas nenit 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

SEKSIONI II

Prodhimi i algave të detit

Neni 8

Përshtatshmëria e mjedisit ujq dhe plani i menaxhimit të qëndrueshëm

1. Aktiviteti prodhues i algave të detit duhet të vendoset në vende që nuk ndoten nga produkte ose substanca, të cilat nuk përdoren në prodhimin biologjik ose nga ndotës të tjerë që ndikojnë në natyrën biologjike të produkteve.

2. Njësitë e prodhimit biologjik dhe jobiologjik duhet të jenë qartësisht të ndara. Ndarja bëhet duke marrë parasysh kushtet në vend, si: sistemet e shpërndarjes së ujit, të cilat duhet jenë të ndara, si dhe distancat dhe vendndodhjen e njësisë së prodhimit biologjik. Në rast dyshimi që prodhimi biologjik mund të ndotet, autoriteti kompetent përcakton vende ose zona të cilat konsiderohen të papërshtatshme për vjeljen e algave të detit, si dhe distancat minimale midis njësive të prodhimit biologjik dhe jobiologjik. Kur përcaktohen distancat minimale ndarëse, autoriteti kompetent duhet të informojë operatorët dhe trupat e kontrollit.

3. Për të gjitha proceset e reja që zbatohen në prodhimin biologjik dhe kur prodhohet më shumë se 20 tonë produkte të algave të detit në vit, duhet një vlerësim mjedisor në proporcion me njësinë e prodhimit, për të përcaktuar kushtet e njësive së prodhimit dhe ndikimet mjedisore të menjëhershme të funksionimit të saj. Operatori i algave të detit duhet të paraqesë vlerësimin mjedisor të trupa e kontrollit dhe përmbajtja e vlerësimit mjedisor bazohet në kërkesat e legjislacionit në fuqi “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Nëse njësia e prodhimit biologjik ka qenë objekt i një vlerësimi mjedisor ekuivalent, atëherë ky vlerësim përdoret edhe për këtë qëllim.

4. Operatori i algave të detit duhet të hartojë një plan të menaxhimit të qëndrueshëm në proporcion me njësinë e prodhimit për vjeljen e algave të detit. Plan duhet të përditësohet çdo vit dhe të detajohen ndikimet mjedisore të aktivitetit, monitorimi mjedisor dhe masat e ndërmarra për të minimizuar ndikimet negative në mjediset ujore dhe tokësore, duke përfshirë shkarkimin e lëndëve ushqyese në mjedis për cikël prodhimi ose për vit. Plan duhet të përfshijë mbikëqyrjen dhe riparimin e pajisjeve teknike.

5. Operatori i algave të detit përdor sipas preferencave burimet e rinovueshme të energjisë dhe materiale të riciklueshme dhe harton si pjesë të planit të menaxhimit të qëndrueshëm një program të reduktimit të mbetjeve, i cili duhet të zbatohet që në fillim të aktivitetit. Përdorimi i nxehtësisë së mbetjeve, kur është e mundur, reduktohet nga përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme.

6. Për vjeljen e algave të detit, duhet të kryhet një vlerësim i biomasës që në fillim të vjeljes, me qëllim ruajtjen e specieve nga zhdukja.

Neni 9

Vjelja e qëndrueshme e algave të egra të detit

1. Në njësinë e prodhimit të algave të detit operatori mban dokumentacionin financiar, i cili i mundëson atij identifikimin dhe trupës së kontrollit, verifikimin, nëse vjelësit kanë vjelë vetëm alga deti të egra të prodhuara në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

2. Vjeljet kryhen në mënyrë të tillë që sasinë e vjela të mos shkaktojnë ndikim ndotës në mjedisin ujor. Për të siguruar rigjenerimin e



algave të detit merren parasysh faktorë, si: teknika e vjeljes, madhësitë minimale, mosha, ciklet e riprodhimit ose madhësia e algave të detit të mbetura.

3. Në rastet kur algat e detit vilen nga një zonë vjeljeje në përdorim të përbashkët nga disa operatorë, dokumentacioni i mbajtur duhet të tregojë që e gjithë sasia e vjelë është kryer në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

4. Të dhënat për vlerësimin e prodhimit të pritshëm që mund të vilet për sezon dhe burimet e ndotjes së mundshme për shtretërit e vjelë tregojnë nëse ka një menaxhim të qëndrueshëm dhe pa ndikim afatgjatë në zonat e vjeljes.

Neni 10

Kultivimi i algave të detit

1. Algat e kultivuara në det duhet të shfrytëzojnë vetëm lëndët ushqyese që ndodhen natyrshëm në mjedisin ku kultivohen ose nga prodhimet shtazore të akuakulturës biologjike, mundësisht të lokalizuara pranë dhe pjesë e një sistemi shumëkulturësh.

2. Për pajisjet në tokë, kur përdoren burimet e jashtme ushqyese, nivelet ushqyese në ujin rrjedhës duhet të jenë njëloj me ujin e ardhur. Përdoren vetëm ushqyesit me origjinë minerale ose bimore dhe që përfshihen në listën e përcaktuar në nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

3. Litarët e pajisjet e tjera të përdorura për rritjen e algave të detit mund të ripërdoren ose të riciklohen.

Neni 11

Masat për pastrimin e makinerive dhe të pajisjeve të prodhimit

1. Pastrimi i pajisjeve dhe i makinerive kryhet nëpërmjet metodave fizike dhe mekanike. Kur pastrimi nuk është i mundur me këto metoda, atëherë për pastrim përdoren vetëm substancat e përfshira në listën e përcaktuar në nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

2. Organizmat e vegjël largohen vetëm me metoda fizike dhe, nëse është e mundur, kthehen në det sa më larg nga ferma.

SEKSIONI III

Rregullat përjashtuese të prodhimit për prodhimin bimor

Neni 12

Prodhimi paralel

Në përjashtim nga rregullat e prodhimit, për të siguruar fillimin apo vazhdimësinë e prodhimit biologjik në ferma që përballen me kushtëzime klimatike, gjeografike ose strukturore, një prodhues mund të menaxhojë në të njëjtën hapësirë njësitë e prodhimit biologjik dhe jobiologjik në rastin:

a) E prodhimit të kulturave shumëvjeçare, të cilat kërkojnë një periudhë kultivimi të paktën trevjeçare, dhe kur varietetet nuk mund të dallohen lehtë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. të gjitha njësitë e prodhimit të përfshihen në një plan kalimi, i cili parashikon fillimin e kalimit në prodhim biologjik të njësisë së fundit, brenda një periudhe 5-vjeçare;

ii. të sigurohet ndarja e përhershme e produkteve të prodhuara nga çdo njësi prodhimi;

iii. të njoftohet trupa e kontrollit për vjeljen e çdo produkti, të paktën 48 orë më parë;

iv. të informohet trupa e kontrollit mbi sasitë e vjela në njësitë e prodhimit dhe masat e zbatuara për ndarjen e produkteve kur përfundon vjelja;

v. të miratohen nga trupa e kontrollit dhe të raportohen tek autoriteti kompetent plani i kalimit dhe masat e kontrollit dhe ky miratim të konfirmohet çdo vit pas fillimit të planit të kalimit;

b) Kur sipërfaqet bujqësore përdoren për kërkime bujqësore të miratuara nga autoriteti kompetent dhe kur provohet që plotësohen kushtet e përcaktuara në shkronjën “a”, nënndarjet “ii”, “iii”, “iv” dhe “v”, të këtij neni;

c) E prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor e transplantëve të tyre dhe kur provohet që plotësohen kushtet e përcaktuara në shkronjën “a”, nënndarjet “ii”, “iii”, “iv” dhe “v” të këtij neni;

ç) E kullotave që përdoren vetëm për kullotje.



Neni 13

Përdorimi i farave ose i materialit shumëzues bimor që nuk janë përftuar me metodën e prodhimit biologjik

1. Në prodhimin biologjik, në rastin e përjashtimit nga rregullat e prodhimit për të siguruar fillimin apo vazhdimësinë e prodhimit biologjik, në ferma që përballen me kushtëzime klimatike, gjeografike ose strukturore përdoren:

a) Farat dhe materiali shumëzues bimor nga një njësi prodhimi në kalim;

b) Farat dhe materiali shumëzues bimor jobiologjike kur kërkesa e shkronjës “a” të kësaj pike nuk mund të zbatohet me lejen e trupës së kontrollit.

2. Për përdorimin e farave jobiologjike zbatohen kërkesat, si më poshtë vijon:

a) Farat jobiologjike përdoren me kusht që të mos jenë trajtuar me produkte të mbrojtjes së bimëve (në vijim PMB), të tjera nga ato të lejuara sipas nenit 6, pika 1, të këtij vendimi, përveç rasteve kur trajtimi është miratuar për qëllime fitosanitare nga autoriteti kompetent për të gjitha varietetet e një lloji të dhënë në zonat ku do të përdoren farat.

b) Trupa e kontrollit lejon përdorimin e farave jobiologjike vetëm në rastet e mëposhtme kur:

i. nuk gjendet asnjë varietet i llojeve që prodhuesi kërkon të prodhojë;

ii. asnjë operator furnizues, nuk mund të shpërndajë fara ose farë patateje biologjike përpara mbjelljes;

iii. varieteti të cilin prodhuesi kërkon të prodhojë nuk gjendet i regjistruar në katalogun kombëtar si varietet i prodhuar nga fara të prodhuara me metodën biologjike dhe prodhuesi vërteton se asnjë nga varietetet e të njëjtit lloj të regjistruara si biologjike nuk janë të përshtatshme;

iv. justifikohet përdorimi në kërkime, testime në fushë, në shkallë eksperimentale ose për qëllime të ruajtjes së varieteteve të miratuara nga autoriteti kompetent;

c) Trupa e kontrollit lëshon lejen për përdorimin e farave jobiologjike para mbjelljes.

ç) Leja lëshohet vetëm për prodhuesit individualë për një sezon e për çdo periudhë dhe trupa e kontrollit regjistron sasitë e farave të lejuara.

d) Në përjashtim të përcaktimit në shkronjën “ç” të këtij neni, autoriteti kompetent lëshon një

leje të përgjithshme për të gjithë përdoruesit për një varietet kur dhe për sa kohë plotësohet kushti, sipas përcaktimit në shkronjën “b”, nënndarja “i” dhe/ose nënndarja “iii”, të këtij neni.

KREU III**RREGULLAT E KALIMIT PËR BIMËT, PRODUKTET BIMORE DHE ALGAT E DETIT**

Neni 14

Rregullat e kalimit për bimët dhe produktet bimore

1. Bimët dhe produktet bimore konsiderohen biologjike, kur në parcelat e prodhimit të tyre zbatohen rregullat e prodhimit të përcaktuara në ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, dhe në kreun II të këtij vendimi, gjatë një periudhe kalimi, të paktën dy vjet para mbjelljes, ose në rastin e kullotës ose foragjereve shumëvjeçare, të paktën dy vjet para përdorimit si ushqim për kafshë nga fermat biologjike, ose në rastin e kulturave shumëvjeçare përveç foragjereve, të paktën tre vjet para vjeljes së parë të produkteve biologjike.

2. Trupa e kontrollit vendos për të njohur si pjesë të periudhës së kalimit çdo periudhë të mëparshme në të cilën:

a) Parcelat kanë qenë subjekt i masave të përcaktuara në një program zyrtar, me kusht që këto masa të sigurojnë që në parcela nuk janë përdorur produkte të palejuara për përdorim në prodhimin biologjik;

b) Parcelat kanë qenë tokë ose tokë bujqësore djerrë, të cilat nuk janë trajtuar me produkte të palejuara.

3. Periudha, sipas përcaktimit në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, mund të merret parasysh vetëm nëse operatori i paraqet trupës së kontrollit prova dhe dokumente të mjaftueshme që vërtetojnë se kushtet plotësohen për një periudhë të paktën trevjeçare.

4. Trupa e kontrollit vendos të zgjasë periudhën e kalimit përtej periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në rastet kur toka është ndotur me produkte të palejuara për prodhimin biologjik.



5. Trupa e kontrollit duhet të informojë autoritetin kompetent për të gjitha vendimet për zgjatjen ose reduktimin e periudhës së kalimit.

6. Në rastin e parcelave, të cilat janë certifikuar ose janë në proces kalimi në prodhim biologjik, që trajtohen me një produkt të palejuar, autoriteti kompetent mund të shkurttojë periudhën e kalimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, vetëm në rastet kur parcelat janë pjesë e:

a) Masave të detyrueshme për kontrollin e sëmundjeve ose të dëmtuesve, të përcaktuara nga autoriteti kompetent;

b) Testimeve shkencore të miratuara nga autoriteti kompetent.

7. Në rastet e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni, kohëzgjatja e periudhës së kalimit caktohet duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

a) Procesi i degradimit të produktit të përdorur të garantojë një nivel të papërfillshëm të mbetjeve në tokë në fund të periudhës së kalimit dhe në rastin e kulturave shumëvjeçare në bimë;

b) Prodhimi i vjelë pas trajtimit nuk mund të shitet duke iu referuar metodës së prodhimit biologjik.

Neni 15

Periudha e kalimit për algat e detit

1. Periudha e kalimit në prodhim biologjik për një zonë vjeljeje të algave të detit të egra është gjashtë muaj.

2. Periudha e kalimit në prodhim biologjik për një njësi kultivimi të algave të detit është më e gjatë se gjashtë muaj ose sa një cikël i plotë prodhimi.

KREU IV

RREGULLAT E HOLLËSISHME TË KONTROLLIT PËR PRODHIMIN BIMOR DHE ALGAT E DETIT

SEKSIONI I

Rregullat e hollësishme të kontrollit për bimët dhe produktet bimore të prodhuara ose të mbledhura nga ferma

Neni 16

Masat e kontrollit

1. Për bimët dhe produktet bimore të prodhuara ose të mbledhura nga ferma zbatohen rregullat e hollësishme të kontrollit, të përcaktuara në këtë kre.

2. Çdo njësi prodhimi biologjik duhet të ketë një përshkrim të plotë të njësisë, i cili:

a) Hartohet edhe kur operatori ushtron aktivitetin e tij vetëm në mbledhjen e bimëve spontane;

b) Përmban magazinat, ambientet e prodhimit, parcelat dhe/ose zonat e mbledhjes së bimëve spontane, si dhe, kur është e mundur, ambientet në të cilat realizohen proceset e përpunimit dhe/ose paketimit;

c) Specifikon datën e trajtimit të fundit me produkte të palejuara në prodhimin biologjik në parcelat dhe/ose zonat e mbledhjes.

2. Në rastin e mbledhjes së bimëve spontane, për të siguruar përputhshmërinë me rregullat e prodhimit biologjik, operatori duhet të marrë një vërtetim nga autoritetet kompetente zyrtare, që vërteton se plotësohen kërkesat e nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

Neni 17

Komunikimet

Çdo vit, para datës së kërkuar nga trupa e kontrollit, operatori i prodhimit biologjik e njofton atë lidhur me planin e prodhimit të produkteve bujqësore, të ndarë sipas parcelave.

Neni 18

Të dhënat për prodhimin bimore

1. Të dhënat për prodhimin bimore mbahen nga operatori në formën e një regjistri dhe duhet të jenë të disponueshme për trupën e kontrollit në çdo kohë.

2. Përveç planit të prodhimit, sipas nenit 17 të këtij vendimi, regjistri duhet të përmbajë të paktën informacionin për:

a) Përdorimin e plehrave, si: datën e përdorimit, llojin, sasinë e plehut dhe parcelën ku përdoret;

b) Përdorimin e PMB-së, si: arsyen, datën e trajtimit, llojin dhe metodën e trajtimit;

c) Furnizimet me *input*-e të fermës, si: datën, llojin dhe sasinë e produktit të blerë;

ç) Vjeljet, si: datën, llojin dhe sasinë e prodhimit biologjik ose prodhimit në kalim.



Neni 19

Menaxhimi i disa njësisve të prodhimit nga një operator

Në rastin kur operatori menaxhon disa njësi prodhimi biologjike dhe jobiologjike në të njëjtin vend, edhe njësitë që prodhojnë prodhime jobiologjike, së bashku me objektet e magazinimit për *input*-et në fermë duhet të zbatojnë rregullat e përgjithshme dhe të hollësishme të kontrollit, të përcaktuara në ligjin nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, dhe në këtë vendim.

SEKSIONI II**Rregullat e hollësishme të kontrollit për algat e detit**

Neni 20

Masat e kontrollit

1. Kur operatori aplikon për herë të parë për t’u përfshirë në sistemin e kontrollit të prodhimit biologjik, përshkrimi për njësinë e prodhimit përfshin:

- Një përshkrim të plotë të instalimeve në tokë dhe në det;
- Vlerësimin mjedisor;
- Planin e menaxhimit të qëndrueshëm.

2. Për algat e detit të egra hartohet një përshkrim i plotë, siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, si dhe një hartë e zonave bregdetare ose detare të grumbullimit dhe zonave tokësore ku ndodhin aktivitetet pas grumbullimit.

Neni 21

Të dhënat për prodhimin e algave të detit

1. Të dhënat për prodhimin e algave të detit mbahen nga operatori në formën e një regjistri dhe janë të disponueshme për trupën e kontrollit në çdo kohë. Këto të dhëna përmbajnë të paktën:

- Listën e specieve, datën dhe sasinë e vjelë;
- Datën e përdorimit, llojin dhe sasinë e plehrave të përdorura.

2. Për mbledhjen e algave të detit të egra, regjistri, përveç të dhënave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përmban edhe:

- Historikun e aktivitetit të vjeljes për çdo specie në shtretërit e përcaktuar;

b) Vlerësimin e prodhimit të pritshëm që mund të vilet për sezon;

c) Burimet e ndotjes së mundshme për shtretërit e vjelë;

ç) Prodhimin e qëndrueshëm vjetor për çdo shtret.

VENDIM**Nr. 337, datë 6.6.2018****PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR SEZONIN E VERËS 2018, NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA, PRANË MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18, pika 2, dhe 18/1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e 500 (pesëqind) punonjësve me kontratë të përkohshme për sezonin e verës 2018 në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vendet e punës të përcaktuara në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Detajimi i numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme sipas emërtesës së vendit të punës bëhet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

2. Periudha kohore e veprimtarisë sezonale, që do të kryejnë punonjësit me kontratë të përkohshme, është 2 muaj, korrik - gusht 2018.

3. Punonjësit me kontratë të përkohshme përfitojnë pagën bazë minimale, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Fondi i pagave për numrin e punonjësve të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi,



përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018, në shumën 35 010 000 (tridhjetë e pesë milionë e dhjetë mijë) lekë, i cili i akordohet programit buxhetor “Zhvillimi i turizmit”, me kod 04760.

5. Efektet financiare do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të kontratës së përkohshme, ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në cilësinë e punëdhënësit, dhe punëmarrësit.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Lidhja nr. 1

Nr.	Lloji i aktivitetit	Emërtesa e vendit	Gjendja
1	Pikat kufitare	Pika kufitare e Morinës (Kosova)	Për t'u ngritur
2		Pika kufitare e Murriqanit (Mali i Zi)	Për t'u ngritur
3		Porti i Durrësit (Itali, BE)	Për t'u ngritur
4		Aeroporti i Tiranës (të gjitha drejtimet)	Për t'u ngritur
5		Pika kufitare e Qafëthanës (Maqedoni)	Për t'u ngritur
6		Porti i Vlorës (Itali, BE)	Për t'u ngritur
7		Pika kufitare e Kapshticës (Greqi)	Për t'u ngritur
8		Pika kufitare e Kakavijës (Greqi)	Për t'u ngritur
9		Porti i Sarandës (Greqi)	Për t'u ngritur
		TOTALI	
1	Info point/plazhe	Plazhi i Velipojës	Për t'u ngritur
2		Plazhi i Shëngjinit	Për t'u ngritur
3		Gjiri i Durrësit (disa pika)	Për t'u ngritur
4		Lungomare e Vlorës	Për t'u ngritur
5		Zona e Orikum-it (qendra e Rradhimës)	Ekzistuese
6		Llogora (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
7		Plazhi i Dhërmiut	Për t'u ngritur
8		Plazhi/qytetit i Himarës e zonat përreth	Për t'u ngritur
9		Zona e Ksamilit	Për t'u ngritur
10	Info point/ qendra vizitorësh	Qyteti i Shkodrës	Për t'u ngritur
11		Parku i Thethit (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
12		Parku i Valbonës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
13		Qyteti i Beratit	Për t'u ngritur
14		Qyteti i Pogradecit	Për t'u ngritur
15		Qyteti i Përmetit (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
16		Qyteti i Gjirokastrës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
17		Qyteti i Korçës (qendër vizitorësh)	Ekzistuese
		TOTALI	

**VENDIM****Nr. 338, datë 6.6.2018****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 103, DATË 4.2.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN DHE MËNYRËN E
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË
MJEDISIT DHE PYJEVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, pika 1, dhe 11, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 103, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Në titull dhe në vendim, emërtimi “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave” dhe akronimi “ISHMPU” zëvendësohen përkatësisht me “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit” dhe “ISHMPUT”.

b) Kudo në vendim, fjalët “... ministria që mbulon fushën e mjedisit ...” dhe “... ministri përgjegjës për mjedisin ...” zëvendësohen me “... ministria që mbulon fushën e turizmit dhe mjedisit ...” dhe “... ministri përgjegjës për turizmin dhe mjedisin ...”.

c) Kudo në vendim, fjalët “... në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave ...” zëvendësohen me “... në fushën e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit ...”.

ç) Pikat 1, 2, 3, të kreut të II, ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. ISHMPUT-ja ka si mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes nga kundërvajtjet administrative të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit.

2. ISHMPUT-ja është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit që lidhen me dënimet për kundërvajtjet administrative në fushën përkatëse, në përputhje me përgjegjësitë e

ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreut, ISHMPUT-ja është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, për inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e turizmit dhe mjedisit, lidhur me kundërvajtjet administrative.”.

d) Shkronjat “dh” dhe “e”, të pikës 3, të kreut III, ndryshohen si më poshtë vijon:

“dh) siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit lidhur me dënimin për kundërvajtjet administrative;

e) ushtron çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe turizmin nga kundërvajtjet administrative.”.

dh) Në pikën 7, të kreut III, pas fjalëve “... drejtorin përgjegjës për inspektimin e ujërave;” shtohen “... drejtorin përgjegjës për inspektimin në fushën e turizmit;”.

2. Nëpunësit civilë aktualë të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), të cilët kryejnë funksionet e inspektimit për kundërvajtjet administrative në fushën e turizmit, funksione të cilat kalojnë në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, transferohen me përparësi pranë ISHMPUT-së, në zbatim të legjislacionit të nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucioneve.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shkronja “e”, e pikës 4, të kreut II, të vendimit nr. 36, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, shfuqizohet.

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**VENDIM****Nr. 339, datë 6.6.2018****PËR KRITERET DHE MËNYRËN E
NDARJES SË ÇMIMIT “AMBASADOR
I KOMBIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve dhe të mënyrës së ndarjes të çmimit “Ambasador i Kombit”.

2. Ndarja e çmimit “Ambasador i Kombit” udhëhiqet nga parimet e vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës, mirënjohjes publike. Kriteret, që duhet të plotësojnë pjesëtarët e suksesshëm të diasporës për marrjen e çmimit, janë:

a) Integriteti dhe reputacioni në komunitetin ku ai/ajo jeton;

- b) Përfaqësimi i suksesshëm në diasporë në:
- veprimtari humanitare;
 - arsim, shkencë, teknologji;
 - kulturë apo sport;
 - biznes.

c) Kontributi i veçantë për Republikën e Shqipërisë apo diasporën.

3. Ambasadorët e Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme, i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën përfaqësuesit më të suksesshëm të komuniteteve shqiptare jashtë vendit për dhënien e çmimit “Ambasador i Kombit”.

4. Propozimet duhet të shoqërohen me biografinë dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së subjektit të propozuar.

5. Ministri përgjegjës për diasporën vlerëson propozimet e ardhura, së bashku me rekomandimet për dhënien e çmimit, dhe ia propozon ato, zyrtarisht, Kryeministrit.

6. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet nga Kryeministri.

7. Çmimi “Ambasador i Kombit” i dorëzohet personalisht personit që merr çmimin, por, në raste të veçanta, mund t’i dorëzohet edhe familjarëve apo përfaqësuesve të tij.

8. Çmimi “Ambasador i Kombit” nuk ka vlerë monetare.

9. Çmimi “Ambasador i Kombit” jepet në formën e një certificate.

10. Forma e certificate “Ambasador i Kombit” është sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Përjashtimisht, për raste të veçanta, propozimi për çmimin “Ambasador i Kombit” mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me këtë vendim dhe, në këtë rast, nuk do të zbatohet parashikimi i pikës 3.

12. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi





T'a dish dhe të jesh i sigurtë, se falbardhëria dhe lundunija jote gjendet në Shqipëri e cila t'op nder dhe të fal emrin shqiptar.

Ruaje mirë karakterin komtar dhe kryengritësinë shqiptare; bindju ligjeve dhe urdhrave të vendit kudo, që të jesh.

Çdo shqiptar është vllau Yll; nderoje kurdhëri dhe ndihmoje kur të ketë nevojë.


Mos e përbuz gjuhën e motës së atë tue folë në gjuhë të hugj kur nuk asht nevojta.

Ndëro flamurin e atdheut tond; kush nuk e nderon shënjën e komisë stunderon veten e vet.

Dashunija për atdhe ndihet ma tepër në mërgim, prandaj këtë dashuri ruaje edhe kur të kthehesh në vendin t'and.







**VENDIM****Nr. 340, datë 6.6.2018****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR KUSHTET DHE
MËNYRËN E ZGJEDHJES SË
PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT
KOORDINUES TË DIASPORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së 15 përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës.

2. Përfaqësuesit e diasporës, kandidatë për anëtarë në Këshillin Koordinues të Diasporës, përveç kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 16/2018, “Për diasporën”, duhet të jenë:

a) Persona të spikatur në fushat e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës, sportit etj. apo të suksesshëm në fushën e biznesit;

b) Persona të njohur në fushën e filantropisë dhe të kenë kontribuar në çështje që lidhen me diasporën apo vendin e origjinës;

c) Pjesë aktive e forumeve organizative të diasporës në vendet pritëse.

3. Për procedurën e propozimit e të zgjedhjes duhet të zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

4. Numri i kandidaturave duhet të jetë jo më pak se dyfishi i numrit të përfaqësimit, duke iu referuar rendit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 20, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”.

5. Ambasadorët e jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, të akredituar jashtë vendit, nëpërmjet ministrit përgjegjës për punët e jashtme, i propozojnë ministrit përgjegjës për diasporën kandidatët për Këshillin Koordinues të Diasporës.

6. Ambasadorët bashkëpunojnë me organizatat e diasporës, të njohura e të regjistruara sipas legjislacionit të vendit pritës, për gjetjen e kandidaturave.

7. Për raste të veçanta ose në mungesë të kandidaturave të propozuara, propozimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Koordinues të

Diasporës (jo më shumë se 3 propozime) mund të bëhet drejtpërdrejt nga ministri përgjegjës për diasporën.

8. Propozimet duhet të shoqërohen me jetëshkrime e dokumente, kualifikime dhe vlerësime të nevojshme të veprimtarisë së përfaqësuesit të propozuar.

9. Në vijim të propozimeve të ardhura, ministri përgjegjës për diasporën përzgjedh 15 kandidatët për anëtarë të Këshillit Koordinues të Diasporës dhe ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave.

10. Të paktën 30 për qind e anëtarësisë duhet të jetë e përfaqësuar nga gjinia femërore.

11. Përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Diasporës zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë.

12. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës lirohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:

a) Jep dorëheqjen, me kërkesë individuale;

b) Ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit;

c) Lirohet për shkaqe të tjera.

13. Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës shkarkohet para mbarimit të mandatit 4-vjeçar, në rastet kur:

a) Neglizhon kryerjen e detyrave dhe pjesëmarrjen e rregullt në mbledhjet e këshillit drejtues;

b) Nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji nr. 16/2018, “Për diasporën”, dhe nga ky vendim;

c) Nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhje për më shumë se 2 herë radhazi;

ç) Bëhet i paafte për të kryer funksionet e ngarkuara për shkak të sëmundjeve fizike ose mendore;

d) Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron në kundërshtim me interesat e Këshillit Koordinues të Diasporës.

14. Ministri përgjegjës për diasporën, jo më vonë se 30 ditë pune para mbledhjes së ardhshme të Këshillit Koordinues të Diasporës, i propozon Këshillit të Ministrave kandidatët e rinj, për të zëvendësuar anëtarin e liruar apo të shkarkuar. Mandati i zëvendësuesit llogaritet i plotë, nga dita e emërimit të tij.

15. Përjashtimisht për zgjedhjet e para, propozimet duhet të dorëzohen para fundit të muajit gusht 2018.



16. Ngarkohen ministri përgjegjës për diasporën, ministri përgjegjës për punët e jashtme dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VENDIM
Nr. 341, datë 7.6.2018

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Kleopatra Maliqi, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 43, datë 5.2.2018

PËR DETYRIMIN E TREGTIMIT DHE
REGJISTRIMIT TË TË GJITHA
PRODHIMEVE TË PESHKIMIT NË
QENDRAT E GRUMBULLIMIT DHE
ANKANDIT TË PRODHIMEVE
PESHKORE NË SHIROKË DHE ZOGAJ
NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pika 1 e nenit 112 të ligjit 64/2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar, pikës 78 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim” dhe pikës 2, të nenit 40 të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zëniet e kryera me rrjeta dhe grepa në Liqenin e Shkodrës të zbarkohen dhe tregtohen fillimisht në qendrat e grumbullimit dhe ankandit të OMP Shkodër, të ndodhura në Shirokë e Zogaj, të regjistruara pranë autoriteteve kompetente veterinare, sipas ekstraktit të QKL, nr. Ln-2928-02-2011.

2. OMP Shkodër, e cila ka në administrim qendrat Shirokë dhe Zogaj, të përgatisë dokumentacionin e shitjes së parë, sipas kërkesave të kreut VII, “Peshimi i prodhimeve të peshkimit”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”.

3. OMP Shkodër është objekt kontrolli nga inspektorati i peshkimit sipas pikës 1 të nenit 109 të ligjit 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet OMP Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në MBZHR dhe DSHPA.

5. Urdhri i ministrit nr. 349, datë 29.4.2011, “Për detyrimin e tregtimit dhe regjistrimit të të gjitha prodhimeve të peshkimit në qendrat e grumbullimit dhe ankandit të prodhimeve peshkore në Shirokë dhe Zogaj në liqenin e Shkodrës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 6, datë 30.5.2018

